

# Master dhe doktoratë sipas Bolonjës

Oorganizata austriake "Wus Austria" ka paralajmëruar hapjen e tri master programeve të reja dhe dy drejtimeve interdisiplinare në nivelin e doktoratës

Anita Kadriu

**PRISHTINË** → Katër master-programe të reja, sipas standardeve ndërkombëtare, janë duke u implementuar në Universitetin e Prishtinës (UP) me mbështetjen e organizatës austriake për ndihmë arsimit në Kosovë, "Wus Austria". Dy master-programet që llogariten si drejtimet më të reja edhe në rajon, drejtimi i Mekatronikës si dhe drejtimi i Menaxhmentit Shëndetësor kanë si gjuhë të studimeve anglishten, ndërsa në dy mastera tjerë të hapur në Juridik, mësimi organizohet po ashtu në gjuhën angleze me kombinim edhe me ligjërimet në gjuhën shqipe.

Udhëheqësit e kësaj organizate në Kosovë kanë deklaruar se janë në përgatitje edhe të tre master programeve të reja dhe dy drejtimeve interdisiplinare në doktoratë. Drejtori i "Wus Austria", But Dedaj ka thënë për "Zëri" se tri master programet e reja do të hapen në Fakultetin Juridik dhe tashmë janë dërguar për akreditim. Dedaj thekson se këto master programe do të hyjnë në implementim në vitin e ri akademik, në tetor. Ai ka bërë të ditur se kjo organizatë ka marrë përsipër edhe hapjen e dy drejtimeve të doktoratës. "Këto drejtime të doktoratës janë interdisiplinare dhe përfshijnë Fakultetin e Bujqësisë, Fakultetin e Mjekësisë dhe Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore (FSHMN)", tha ai.

Studimet e reja në doktoratë që zhvillohen në kuadër të projektit Tempus, sipas Dedajt, në programin ku bartës është Fakulteti i Mjekësisë, studimet pritet të

fillojnë këtë vit akademik, ndërsa në drejtimin ku bartës është Bujqësia, studimet të fillojnë në vitin e ardhshëm akademik 2011/12. Në secilin drejtim, ai tha se do të regjistrohen nga 15 kandidatë.

Ndërkaq katër master programe të reja që janë duke u zhvilluar në UP, sipas Dedajt, janë për



Universitetet austriake kanë kontribuar edhe me trajnimin e stafit të profesorëve të UP-së

herë të parë në kuadër të programeve të këtij universiteti. Organizimi i këtyre studimeve ka si partner universitetet adekuate të Austrisë. "Janë

marrëveshje që janë lidhur ndërmjet UP-së dhe me fakultetin e juridikut në Grac. E drejta ndërkombëtare dhe e drejta pronësore civile zhvillohen me këto marrëveshje të binjakëzimit që si rezultat kanë prezencën e profesorëve austriakë me mbajtjen e ligjëratave këtu". Sipas tij, universitetet austriake kanë kontribuar edhe me trajnimin e stafit të profesorëve të UP-së.

Drejtimi i menaxhmentit shëndetësor është duke u zhvilluar me përkrahjen e Universitetit të Mjekësisë në Vjenë, ndërsa me Universitetin e Shkencave të Zbatuara nga Graci, ka marrëveshje Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike si dhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike ku zhvillohet master programi mekatronika. "Dy programet, menaxhmenti shëndetësor dhe mekatronika për herë të parë mbahen komplet në gjuhën angleze", tha ai.